

FJALA E DEPUTETIT AGRON GJEKMARKAJ

E HËNË 30 MAJ 2022

E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar deputetë të paktë në sallë,

Unë nuk jam kaq entuziast në të folur, sa kolegia Klotilda, kur salla është bosh, megjithatë do të bëj detyrën, do të flas. Mes dyshimeve, pikëpyetjeve dhe dilemave nëse jam opozitar i vërtetë apo i shitur, safi apo i blerë, flori 24- karatësh apo prej tunxhi, i ndershëm apo i rremë, u nisa ta marr fjalën sot. Jetojmë në kohë të çuditshme, kur njeriu mendon se e di çfarë është, por jo, i duhet të presë me dorë në zemër që të tjerët t'ia thonë dhe pastaj vetveten të gjejë. Megjithatë, vendosa të ec në këtë turbullirë dhe të trajtoj disa tema.

Sot u dogj edhe raundi i tretë për zgjedhjen e Presidentit të Republikës. Kjo nuk ishte rastësi, as gjë e re, dihej dhe pritej. Shtegu i vetëm, ku kalon hipokrizia dhe zgërdhirja ndaj shqiptarëve ishte ky shteg. Maxhoranca për asnjë çast nuk ka pasur qëllim konsensusin apo të ndërtojë një proces me opozitën, por thjesht të bëjë spektakël me shpenzimet e opozitës. Kjo sipërmarrje i rrinte si zhguall breshke ngushtë, shumë ngushtë, sepse lideri po e kërkon President “mavrinë” në askund që ai ose ajo të jetë "askushi", në raport me pavarësinë institucionale. Kryeministri në mandatin e tij të tretë bezdiset nga çdo rezistencë, nga lehja e qenve në Surrel; nga cicërima e zogjve; nga poezitë dhe këngët e vartësve; nga çdo mendim që nuk është i veti; nga çdo portret që nuk e zografit vetë. Ndaj, durim!

Ai po vizaton portretin e admiruesit të tij, që do të vendosë në krye të shtetit për të realizuar kësisoj mbylljen e kapjes së çdo institucioni, nocioni dhe personi në një republikë të thyer në mes nga i njëjti ves, që karakterizon shtetin tonë nga pavarësia e këtej, i cili është uni, i lyer me dëlir dhe i mbuluar me nevojë sundimi. CV -ja e tij në historinë e politikës shqiptare do të shkruhet nga një njeri, nga ai që ndan të mirën nga e keqja, të drejtën nga e gabuara, të ëmblën nga e tharta. Të tjerët flasin kot, sepse asgjë nuk dinë, thjesht do të votojnë në rresht sapo të marrin sinjalin. Presidenti, që del nga raundi i katërt, ka një detyrim, çdo pasdite të marrë Kryeministrin e ta pyesë: po ku je, o shyqyri i kombit?!

A u lodhe sot, o mezja e vendit?! A të mërzhitën, o gëzimi i shoqërisë?! Si je, o i bukuri i tezes?! Më mori malli, o i miri i dajës! Kush ta prishi qejfin, që mos bëftë hajër, o lezeti i Europës?! A të të bëj një kafe, o

Skënderbe, që të mbledhësh midenë dhe t'i bësh copash taborët armike që ke nëpër këmbë?! Ndërsa opozita humbi një rast, jo për të pasur një President, se në asnjë çast nuk do ta kishte atë, por për të bërë diferencën etike me një kandidaturë të vetme përbashkuese.

Të nderuar kolegë,

Politika dhe ekonomia janë gjithmonë në simbiozë. Një politikë e keqe, amatore, përfituese apo korruptive nuk ka qëllim mirëqenien e shoqërisë, por atë të individit klient dhe frekuentues oborri. Siç thotë Viktor Hygo: “Nga ferri i të varfërve krijohet parajsa e të pasurve”. Askush nuk po pyet për sipërmarrësit e vegjël. E kam fjalën për peshkatarët, ata të Shëngjinit, të Vlorës, të Sarandës, ndonëse, ata që duhet të bëjnë pyetësorët, peshkun e hanë duke lëvizur bulçitë me ritëm turbine. Në Shëngjin anijet rrinë lidhur, sepse nafta është dyfishuar, nuk dalin në det, sepse nuk balancojnë humbjet me fitimin. Pak muaj më parë, nëse doni ta dini, 1 kilogram Merluc kushtonte 4500 lekë, ndërsa tani kushton 8000 lekë të vjetër.

Pra, as nuk zihet, as nuk konsumohet, duke vënë në diskutim mbijetesën e disa kategorive që gravojnë rreth peshkimit. Kjo që vlen për Shëngjinin, vlen për të gjitha qytetet e tjera. I njëjti problem shfaqet në bujqësi, në tokat e Zadrimës, e Torovicës, e Bregut të Matës, e Fushë-Kuqes, e Ishull-Shëngjinit, e IshullLezhës dhe kudo tjetër që po lënë tokën djerrë nga kostot e papërbalueshme të lërimin, mbjelljes, por edhe të mostregtimit të produkteve. Fshatarët po futen në krizë mbijetese nga një sërë krizash që ata i rrethojnë. Torovica s'ka as më minimalen, ujin e pijshëm. Pak muaj më parë i kërkova ministres Balluku të presë një përfaqësi nga kjo zonë për të diskutuar për perspektivën e një ujësjellësi, sepse mendoj se ata kanë të drejtë të pinë ujë, por nuk e di as t'i ketë pritur dhe as t'i ketë kërkuar ndokujt që t'i shoqërojë në ministri dhe shpresoj që ta bëjë një ditë.

Një rixha e kam edhe për ministren Kushi që të mundohet të gjejë një fond për shkollën e Ishull-Shëngjinit në Lezhë, e cila ngjan me një kotec dhe jo me një shkollë. Gjëja më pikante, që bie në sy, është rruga si grykë shisheje, Milot –Shëngjin, e cila është një tmerr pa fund për trafikun në prag sezoni, ku çdo ditë trafiku arrin deri në 20 kilometra. Një rrugë e tillë kërkon kohën e vet për t'u zgjeruar apo për të gjetur zgjidhje të tjera. E kemi shtruar këtë problem që në muajin shtator dhe e dinim që nuk do të bëhej në pak muaj, por së paku të fillonte një vëmendje për të. Asgjë nuk është bërë deri tani. U bëj thirrje edhe deputetëve socialistë të qarkut të Lezhës të mos heshtin, sepse, pa atë rrugë, s'ka turizëm. Veriu është Shqipëri po aq sa Jugu dhe Lezha po aq sa Vlora e Llogaraja.

Të nderuar kolegë,

Gjërat në vendin tonë lëvizin ngadalë, sepse me të mbaruar zgjedhjet fillon arroganca. Qytetarët nuk kanë asnjë mundësi të shprehen, dhe unë përfitoj nga ky moment t'u kërkoj mbështetje kolegëve deputetë, të majtë apo të djathtë, që të marrim një nismë për të ndryshuar ligjin për referendumet. Ai ligj, ashtu siç është sot, praktikisht i shkurajon, i shkëshillon dhe i ndalon referendumet. Në çdo nen të tij porosit se si qytetarët të mos bëjnë referendum, se si të mos flasin, se si të mos bëhen bashkë, se si të mos rezistojnë dhe se si të mos e shqetësojnë pushtetin. Ndryshimi i tij në favor të qytetarëve dhe në uljen e kufizimeve të panumërta që e karakterizojnë do t'i jepte frymëmarrje demokracisë sonë të kapur.

Me referendum qyteti mund të shprehej për teatrin, për Butrintin, për ligjin e arsimit të lartë, për inceneratorët, për korrigjimet kushtetuese, për drejtësinë dhe për çdo temë tjetër që bie ndesh me interesat shoqërore. Te përgjumja e ndërgjegjes publike mbillet fara e çdo diktature. Shumëkush i ka sytë nga kjo sallë dhe pret prej saj, por po kaq të shumtë janë ata që zhgënjehen nga artikulimi ynë, nga cilësia e fjalës dhe e gjuhës, e cila shpesh ngjan me ata që i drejtohen tjetrit: "O gjigant, o kadaf, o zjarrmi i tokës, o babam, o pasha, o bishë" jo me originalitetin e tyre, por si nxënës të tyre. Vlera e një njeriu matet me numrin e gjërave, për të cilat turpërohet, thotë Bernard Shaw, e cila vlen edhe për deputetët e Shqipërisë.

Në fund, siç e lyp qejfi ynë dhe profesioni im, ju përsëndes me vargjet e Çajupit kushtuar bariut: "Shikoni barin' e gjurë: në diell a në dëborë, bariu me shkop në dorë ruan deshtë me këmborë. Vështronje barinë mirë, me të ngrënë e me të pirë, t'u marrë dhentë pa gdhirë, t'i kullosë me dëshirë, Hani, moj bagëti, hani, kur të vdes do të më qani, për mua zi do të mbani!" Faleminderit!